

Doganë dhe Shpedicion - Master (MA)

Udhëheqës i Programit:

Ismail Mehmeti, PhD

pjeterbudi@gmail.com

tel: +381 38 234 566

Nëse keni synuar të bëheni pjesë e strukturave të larta menaxheriale në administratën doganore, ejani dhe studioni në programin studimor Doganë dhe Shpedicion Master. Këtë privilegj ua ofron vetëm Kolegji “Pjetër Budi” – Prishtinë, i cili është i vetmi institucion universitar i akredituar për studime të nivelit të avancuar për Doganë dhe Shpedicion, në vend dhe rajon.

Ju duhet të bëni zgjedhjen e duhur të jetës, të përcaktoheni për të studiuar drejtime zhvillimore të cilat ju mundësojnë punësim të sigurt. Nëse bëni zgjedhjen e duhur, ju për një kohë të shkurtër do të jeni ekspert i doganave, shpedicionit, logjistikës, tregtisë dhe biznesit ndërkombëtar, do të bëheni drejtues i bordeve të kompanive të mëdha, do të bëheni lider i vërtetë.

Në kolegjin tonë programet akademike të nivelit Master zgjasin dy vite akademike. Mësimi dhe hulumtimi shkencor zhvillohet në katër semestra. Diploma Master në Doganë dhe Shpedicion ju mundëson të vazhdoni studimet në nivelin Doktoratë (Ph.D). Çdo institucion akademik në vend apo kudo në botë, nga ju do të kërkojë pikërisht Diplomën MA, për t’u pranuar në studimet e doktoratës.

Me mbarimin e studimeve Master në këtë program studimor do të fitoni njohuri, shkathtësi dhe kompetencë pune për të punuar në nivelet e larta menaxheriale në administratën doganore, tregti dhe biznes ndërkombëtare, sistem devizor ndërkombëtar, shpedicion të brendshëm, shpedicion ndërkombëtar, logjistikë, menaxhim të logjistikës, etj.

Programi fokusohet në ofrimin e lëndëve me dimension ndërkombëtar, për të plotësuar nevojat e tregut të punës dhe punësimit me karakter rajonal dhe global. Ky program përgatit kuadro me dije dhe kompetencë nga integrimet evropiane, për konventat dhe institucionet ndërkombëtare doganore, Organizatën Botërore Tregtare, Organizatën Botërore Doganore, menaxhimin e shpedicionit global, sistemet transportuese dhe logjistikë etj.

Programi studimor Doganë dhe Shpedicion MA (Master) është akredituar nga Agjencia Kosovare e Akreditimit dhe ka marrë vlerësimet më të larta nga ekspertët e jashtëm të vlerësimit të cilësisë, në bazë të të cilit vlerësim edhe është akredituar Kolegji “Pjetër Budi”.

Të gjithë studentët e Kolegjit “Pjetër Budi” janë shumë të kënaqur, prandaj bëhuni edhe ju njëri prej shumë të tjerëve.

Me të mbaruar të studimeve në programin akademik Doganë dhe Shpedicion MA, ju mund të punoni kudo, si në sektorin publik ashtu edhe në sektorin privat. Diploma e “Pjetër Budit” ka vlerë të madhe.

Do të mund të punësoheni:

- Në nivelet e larta menaxheriale të administratës doganore
- Menaxher të agjencioneve të shpedicionit
- Mund të hap biznese të ndërmjetësimit në fushën e doganave
- Ekspertë në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, për anëtarësim në Organizatën Botërore Tregtare
- Themelues të bizneseve private që merren me qarkullimin ndërkombëtar të mallrave dhe shërbimeve

- Ekspertë në Ministri të Financave, në fushën e sistemit dhe politikës doganore
- Këshilltarë të Qeverisë
- Pjesëmarrës në hartimin e draftligjeve për tregti me jashtë
- Përfaqësues të Kosovës në Forumet Ndërkombëtare për Tregti dhe Biznes Ndërkombëtar
- Përfaqësues të Kosovës në nënshkrimin e marrëveshjeve për tregti dhe integritime evropiane etj.

A e dini se menaxherët e lartë në administratën doganore nuk kanë kualifikim të lartë në fushën e Doganës dhe Shpedicionit? Ky kualifikim është i nevojshëm për ta, prandaj ju me diplomën Master Doganë dhe Shpedicion e keni vendin atje.

Në Republikën e Kosovës ushtrojnë aktivitet afarist më shumë se 1000 biznese të fushës së ndërmjetësimit doganor dhe shpedicionit, të cilat kryejnë punë të shpedicionit vendor. Kjo lëmi është shumë e rëndësishme të marrë zhvillim dhe karakter ndërkombëtar. Diploma Master Doganë dhe Shpedicion ju mundëson zhvillimin e shpedicionit dhe logjistikës ndërkombëtare, si komponentë e rëndësishme e tregtisë dhe biznesit ndërkombëtar.

Me diplomën e Kolegjit “Pjetër Budi”, ju mund të punësoheni menjëherë!!! \